REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 144/22
Datë/Datum. 28.02.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI VJETOR

2021

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Shkurt, 2022

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
Themelimi dhe Sfidat për të ardhmen e OSHP-SË
2. KORNIZA LIGJORE / BAZA LIGJORE
Baza ligjore ekzistuese
Përmirësimi i bazës ligjore
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT
Misioni/Vizioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit
Faqja e Internetit
4. FUSHËVEPRIMI Që MBULON INSTITUCIONI I OSHP-SË
Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik
5. REKOMANDIMET/SFIDAT E OSHP-SË (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)
Organizimi, veprimtaria, personeli dhe niveli i rrogave
Organizimi, veprimtaria, personeli dhe niveli i rrogave
Bordi
Sekretariati
Burimet Njerëzore
Numri i punëtorëve
Nevojat për punëtorët të rijnë
Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim
6. AKTIVITETI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE
Puna gjatë vitit 2021
Gjobat dhe Ankesat
Të hyrat e inkasuara nga gjobat e shqiptuara ndaj autoriteteve kontraktuese
Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik
Urdhëresat e Shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese
Diskualifikimi i Operatorëve Ekonomikë
Të Dhënat nga Gjykatat

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
Themelimi dhe Sfidat për të ardhmen e OSHP-SË

Ky raport përbehet nga gjithsejtë gjashtë pika kryesore :

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
2. KORNIZA LIGJORE / BAZA LIGJORE
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT
4. FUSHEVEPRIMI Që MBULON INSTITUCIONI I OSHP-SË
5. REKOMANDIMET/SFIDAT E OSHP-SË (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)
6. AKTIVITETET PER PERIUDHEN RAPORTUESE

Organi Shqyrtues i Prokurimit funksionon në bazë te kompetencave që i janë dhënë nga **PJESA VIII, e Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.**

OSHP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

OSHP është organ i pavarur për shqyrtim administrativ. OSHP-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Bordit. Për mbështetje administrative OSHP-së i ndihmon Sekretariati i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit. Asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP apo ndonjë punonjësi të tij për ndonjë vendim. Ndikimi nuk do të konsiderohet politik apo i paligjshëm nëse shfaqet në mënyre të hapur, në pajtim me rregullat e ligjit dhe procedurave, dhe në besim të plotë se haptas avancon ankesën ose mbrojtjen.

OSHP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. OSHP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme, ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës, në masë të njëjtë sikurse autoritetet e tjera publike dhe organizatat buxhetore.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron, se Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 05-V-261 të datës 30 mars 2016, ka emëruar Kryetarin dhe dy anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit për një mandat pesë (5) vjeçar, ashtu siç e parasheh Ligji për Prokurim Publik i Republikës së Kosovës, ku vendimi i lartcekur ka hyr në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi. Andaj duke pas parasysh faktin se me 30.03.2021, bordi ka mbushur pesë (5) vjet nga emërimi i tyre , OSHP nga data 30.03.2021 është pa Kryetar dhe pa asnjë anëtar bordi.

Marr parasysh faktin se në kohën e emërimit të bordit të OSHP-së, sipas vendimit të lartcekur, OSHP veçse ka pasur dy anëtar bordi, por vetëm pas disa muajve të njëjtit me datën 07 korrik 2017, me anë të vendimit P.Sh. Nr. 494/17 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, konform nenit 101 të Ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092 dy (2) anëtarë të bordit janë suspenduar meqë Kuvendi i Kosovës ka njoftuar Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit se në Gjykatën Themelore në Prishtinë është ngritur aktakuzë për të njëjtit prandaj Organi Shqyrtues i Prokurimit ka funksionuar vetëm me Kryetarin dhe dy anëtarët e emëruar sipas vendimit Nr. 05-V-261 të datës 30 mars 2016.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se sipas nenit 100 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit duhet të jetë i përbërë nga pesë (5) anëtarë, të cilët propozohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2. BAZA LIGORE/ KORNIZA LIGJORE

Organi Shqyrtues i Prokurimit veprimtarinë e ushtron konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimit e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, si dhe legjislacionin dytësor të prokurimit publik të hartuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim

Publik:

- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-2019
- Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave ;
- Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

3. PERSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)

Misioni/Vizioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit

- Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Planit Strategjik të OSHP-së për vitet 2020-2022, si vizion primar ka karakterizimin si një institucion kredibil, efikas dhe efektiv në çështjet e prokurimit publik, si dhe shqyrtimin e ankesave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke i pasur parasysh praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit të tij lidhur me prokurimin publik, dhe ofrimin e mbrojtjes ndaj operatorëve ekonomikë vendorë dhe të huaj lidhur me shkeljet eventuale të bëra nga autoritetet kontraktuese.

- Në përputhje me vizionin primar, Organi Shqyrtues i Prokurimit promovon dhe ngritjen e transparencës, mundësimin në qasje në dokumente publikë, dhe rritjen e kapaciteteve profesionale, si dhe bashkëpunimi me akterët relevantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

- Me kompletimin e bordit OSHP do te siguroj qe te merr vendime unifikuese , duke mos devijuar nga praktikat e mira evropiane dhe për rastet e njëjta do te vendos njësoj.

- Për të arritur synimet e parapara me aktet e brendshëm, Organi Shqyrtues i Prokurimit, bën transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore që mbahen me operatoret ekonomik dhe autoritetet kontraktuese, dhe të gjitha palëve të interesit. Me paraqitjen drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore në ueb sajt, OSHP po arrin atë që gjithmonë ka pasur qëllim të arrij, transparencën në raport me palët e interesit dhe popullatën në tërësi. Rritja e transparencës ndaj operatoreve ekonomik nëpërmjet avancimit të ueb faqes për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara, është një ndër synimet kyç për OSHP-në.

- Duke qenë se e gjithë bota është ballafaquar me situatën me pandemi dhe grumbullimi i shumë personave në një ambient të mbyllur është i rrezikshëm, OSHP gjatë kësaj kohe gjatë kohës qe ka qen me bord ka mbajtur edhe seanca dëgjimore përmes platformës online me palët në procedurë.

- Për më tepër, OSHP ka arritur që pagesa e tarifave për ankesa të realizohet online, duke u mundësuar kështu operatorëve ekonomik ta pranojnë fletëpagesën online, e jo të obligohen të udhëtojnë nga vende të ndryshme të Kosovës për ta pranuar dhe dorëzuar fletë-pagesën fizike si më parë.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i parimeve të përgjithshme të bashkëpunimit në fushën e prokurimit publik, për të shtyrë përpara përpjekjet e përbashkëta për një proces efikas, efektiv dhe transparent në fushën e prokurimit publik.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, si dy institucione përgjegjëse dhe të rëndësishme në fushën e prokurimit publik, me anë të kësaj marrëveshje janë siguruar për shkëmbimin e informatave, mbajtjen e takimeve të rregullta të përbashkëta për adresimin e çështjeve specifike të prokurimit, të sigurohen për bashkërendimin e veprimeve si dhe hartimin e politikave me qëllim të përmirësimit të praktikave sa më të mira të prokurimit.

- Për më tepër, OSHP ka marrëveshje edhe me dy donator të cilët e përkrahin institucionin. Këta donator janë:

  - USAID TEAM (Transparent, Effective and Accountable Municipalities), të cilët na kanë përkrahur në lansimin e modulit të ankesave në e-Prokurim. USAID TEAM gjithashtu e ka përkrahur OSHP-në, në avancimin e ueb-faqes, ku është përmirësuar kërkimi në databazën e lëndëve të institucionit, por edhe në transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore në internet.
  - KSPP (Kosovo Strengthening Public Procurement) projekt i financuar nga Ambasada Britanike, i cili na përkrahë në avancimin/digjitalizimin e plotë të procesit të ankesave në e-Prokurim. Ky projekt gjithashtu do ta përkrahë OSHP-në, në

përmirësimin/reformimin e proceseve të brendshme të institucionit.

Faqja e Internetit

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, me qëllim të rritjes së transparencës përballë të gjitha palëve të involvuara në aktivitete të prokurimit, dhe transparencës karshi qytetarit të Kosovës, ka uebfaqen zyrtare "https:/oshp.rks-gov.net", ku bën publikimin e pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik, të cilët pretendojnë se ju janë shkelur nga autoritetet kontraktuese, raportet e ekspertizave dhe vendimet e panelit shqyrtues për çdo lëndë. Po ashtu, web- faqja përmban versionet elektronike, te të gjitha vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, konkluzioneve, urdhëresave, njoftimeve, ekspertizave, raporteve dhe informatave tjera të rëndësishme lidhur me aktivitetet e OSHP-së, si dhe bënë transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore për shqyrtimin kryesor të ankesave.

  OSHP, në partneritet me projektin USAID TEAM, ka bërë avancimin e web-faqes për të mundësuar kërkime më të lehta të dokumenteve mbi ankesat e parashtruara dhe vendimet e marra në lidhje me to. Poashtu, në kanalin tonë Zyrtar në Youtube mund të gjinden të gjitha video seancat e mbajtura nga viti 2021.

  Gjithashtu web faqja e Organit Shqyrtues vizitohet nga vendet e rajonit po edhe pothuajse nga të gjitha vendet e botës, kjo web faqe përmban verzionin e gjuhës Serbe si dhe Angleze

4.FUSHËVEPRIMI Që MBULON INSTITUCIONI I OSHP-SË

Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik

- Organi Shqyrtues i Prokurimit disponon një mori kompetencash, të specifikuara në pjesën IX, nenin 105 të ligjit të prokurimit publik nr. 04/L-042, të cilat

kompetenca saktësohen si në vijim:

- Të shqyrtojë ankesat nga palët me interes lidhur me shkeljet e pretenduara nga ligji i prokurimit publik;
- Të jap urdhëra ndaj çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar që një person, ndërmarrje ose autoritet publik të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente, dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues i konsideron relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;
- Të jap urdhëra ndaj çdo personi për t`u paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të jap dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues e konsideron relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;
- Të jap urdhër me të cilën menjanjohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike, nëse kontrata publike nuk është nënshkruar ende nga palët kontraktuese;
- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta suspendojë ose përfundojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit, ose ta urdhëroj autoritetin kontraktues zbatimin e vendimit të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;
- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta kompensojë parashtruesin e ankesës;
- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë palë tjetër me interes;
- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që t`i menjanojnë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike dhe/ose financiare të përzgjedhjes, kërkesat dhe/ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit

dhe/ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit;

- Të lëshoj urdhëra me të cilin detyrohen zyrtarët të bëjnë zbatimin e një vendimi dhe/ose urdhëri të OSHP-së;
- Të lëshoj urdhëra për ta shëndrruar një kontratë publike të lidhur si jo-efektive, nëse janë plotësuar rrethanat të përcaktuara me ligj të prokurimit publik;
- Të imponoj gjoba ndaj autoritetit kontraktues, nëse ky i fundit vazhdon implementimin e kontratës përkundër faktit se OSHP e ka shpallur kontratën publike pa efekt juridik; dhe
- Kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj të prokurimit publik dhe ligje përkatëse.

5. REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (Organizimi, veprimtaria, personeli dhe niveli i rrogave, rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)

Përkundër faktit se OSHP gjatë vitit 2021, sipas rekomandimeve të Qeverisë ka punuar me staf të reduktuar shkaku i pandemisë, po ashtu duke pas parasysh faktin, se që nga muaji prill 2021, ka qenë e pa mundur të merret ndonjë vendim nga se OSHP ka funksionuar pa Bord, këto rrethana kanë ndikuar që edhe të mos kemi shumë progres, në arritjen e objektivave dhe rritjen e cilësisë në OSHP.

Për OSHP-në, ka qenë një sfidë e madhe të funksionoj si institucion pa bordin e saj, ngase sipas Ligjit për Prokurim Publik puna kryesore e OSHP-së, ka të beje me vendimmarrjen lidhur me ankesat e operatoreve ekonomik për aktivitete të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese. E që nga përfundimi i mandatit të anëtarëve të bordit palët(AK dhe OE) nuk kanë pranuar asnjë vendim për të gjitha ankesat e parashtruara në OSHP.

Duke pas parasysh faktin se miliona euro u janë bllokuar autoriteteve kontraktues si dhe shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar si rezultat i mos emërimit të bordit të OSHP-së, kjo ka ndikuar në bllokimin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit tek shume autoritete kontraktuese,

po ashtu edhe tek të gjithë parashtruesit e ankesave në ketë fazë sepse ankuesit nuk kanë pranuar ndonjë vendim lidhur me ankesën e tyre të parashtruar.

Vlen për tu theksuar se mos marrja e vendimeve nga bordi për ankesat e operatoreve ekonomik ankues ndikon direkt edhe në biznesin e operatoreve ekonomik ankues sepse të gjitha tarifat e sigurimit të ankesave që janë parashtruar nga operatoret ekonomik në këtë fazë janë të bllokuara nga OSHP dhe nuk mund të ju kthehen operatoreve ekonomik pa vendim të bordit.

Mos emërimi i bordit të OSHP-së, ka ndikuar edhe lidhur me ngecjen e procedurave të prokurimit për kontratat të rëndësishme për shëndetin e qytetareve si dhe për kontratat të ndryshme për interesin e autoriteteve kontraktuese, me ç 'rast është cenuar direkt edhe interesi publik sepse autoritetet kontraktues kanë ngecur në furnizimin e ilaçeve dhe medikamenteve të rëndësishme për të sëmurit neper institucione shëndetësore.

OSHP ka një përvojë të ngjashme nder vite ku mbetet pa bord, ku sipas një praktike të mëparshme të gjitha ankesat e parashtruara në ato periudha është dashtë që t'i refuzojë për shkak të tejkalimit të afatit kohor për vendimmarrje, kjo me gjasë do të ndodh edhe në ketë vit, me çka po ju mohet palëve një e drejt elementare për ankimim. pra mos marrja e vendimeve lidhur me të gjitha ankesat e OE-ve, pa fajin e OSHP-së, ndikon në cenimin e të drejtës së palës për ankesë.

OSHP është i vetmi institucion ku palët e pa kënaqura me vendimet e autoriteteve kontraktues (operatoret ekonomik) lidhur me zhvillimin e ndonjë aktiviteti të prokurimit mund të ankohen, është i vetmi institucion ku merr vendimin më të shpejt lidhur me atë ankese, andaj mosfunksionimi i OSHP-së, në këto rrethana i len hapësirë palëve të pa kënaq për tu ankuar vetëm në gjykatë, e që realisht nuk besojmë se ndonjë OE do ti drejtohet gjykatës në këso raste sepse dihet mirë fakti se gjykata masë sa viteve mund të merrte vendim për rate te këtilla. Andaj për ti dhënë mundësi mbikëqyrjes së parasë publike sa më transparente është e domosdoshme formimi i bordit të OSHP-së, në mënyrë që palët e interesuara për zhvillimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit ti paraqesin parregullsitë për atë aktivitet dhe OSHP të merr vendim meritor dhe të bazuar në ligj .

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, përfaqësohet nga Kryetari, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe përgjegjës për administrimin e përditshëm të veprimtarisë së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Për ndonjë fushë specifike, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit mund të delegojë funksionet dhe përgjegjësitë e tij tek ndonjë anëtar tjetër i Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në mungesë të Kryetarit, kompetencat dhe funksionet e Kryetarit ushtrohen nga anëtari më i vjetër i Organit Shqyrtues i Prokurimit.

- Kryetari i Organit Shqyrtues së Prokurimit njëherit është anëtar i bordit. Bordi mbështetet nga sekretariati, i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit i Organit Shqyrtues të Prokurimit për menaxhimin e punëve ditore.

- Në kuadër të sekretariatit, konform rregullores të Organit Shqyrtues të Prokurimit, funksionon Divizioni i Brendshëm, Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Njësia Ligjore.

Bordi

- Përbërja e anëtarëve të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është pesë (5), mirëpo, prej datës 07 korrik 2017, me anë të vendimit P.Sh. Nr. 494/17 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, konform nenit 101 të Ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092 dy (2) anëtarë të bordit janë suspenduar meqë Kuvendi i Kosovës ka njoftuar Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, iu ishte ngritur aktakuza. Që nga 06 korrik 2017, OSHP punon vetëm me tre anëtar Bordi e që dy ish anëtarëve tani më ju ka skaduar edhe mandati.

- Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të bordit është pesë (5) vjeçar. Mandati i Kryetarit dhe dy anëtarëve aktual ju skadon me datë 30 mars 2021. Me skadimin e mandatit të anëtarëve aktual, OSHP do të mbetet pa bord.

- Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është organ vendimmarrës sa i përket shqyrtimit të ankesave të parashtruar nga operatorët ekonomikë. Punën e tyre e zhvillojnë përmes paneleve shqyrtuese, ku me ç 'rast përmes seancave, qoftë dëgjimore apo të mbyllura, vendosin mbi themelësinë e ankesave të operatorëve ekonomik.

Sekretariati

- Sekretariati udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit, organ i cili është përgjegjës që t'i ofroj mbështetje administrative bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të bëjë menaxhimin e punëve ditore, dhe të zhvilloj politikat e rekrutimit për shërbyes civil dhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm profesional dhe teknikë, varësisht nga nevojat e institucionit, së bashku me Kryetarin e OSHP-së.

Burimet Njerëzore

- Organi Shqyrtues i Prokurimit ka Zyrën për Burime Njerëzore, si njësi e veçantë në kuadër të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës, dhe politikave të punësimit sa i përket të punësuarve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Numri i punëtorëve

- Për vitin 2021, Organi Shqyrtues të Prokurimit e ka mbyllur vitin me Udhëheqësin e Divizionit për pranimin e ankesave, Udhëheqësin e Divizionit të Brendëshem, (1) Zyrtar Kryesor për Financa, një (1) Menaxhere e Personelit, shtatë (7) Ekspert Shqyrtues, tre (3) Zyrtarë të Lartë Ligjorë, dy (2) Zyrtar për Teknologji Informative, një (1) Zyrtar për Pranimin e Ankesave, një (1) Zyrtar për Arkivë, një (1) Zyrtar për të Hyra Financiare, një (1) Përkthyese anglisht – shqip dhe anasjelltas, një (1) Përkthyese serbisht – shqip dhe anasjelltas, një (1) Asistent ekzekutiv të Paneleve Shqyrtuese.

Nevojat për punëtorët të rinjë

- Organi Shqyrtues i Prokurimit ka identifikuar nevoja për punëtorë të rinjë, andaj gjatë vitit 2022, pritet t'i plotësoj edhe tri (3) vende të lira, në bazë të nevojave të institucionit.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka poashtu nevojë për staf shtesë në mënyrë që të zvogëloj angazhimin e ekspertëve të jashtëm, që marrin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të OSHP-së.

Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim

- Gjatë vitit 2021, OSHP, zyrtarët e OSHP-së, kanë ndjekur këto trajnime :
- Auditimi i Burimeve Njerëzore të organizuar nga Instituti i Kosovës për trajnime- IKAP.
- Trajnimin e Avancuar për Prokurimi Publik të organizuar nga Instituti i Kosovës për trajnime- IKAP.
    - "Procedurat e Shqyrtimit Administrativ dhe Administrimi i Punëve në Zyre", të organizuar nga "Prudencia Consulting", në Durrës – Shqipëri.
    - "Menaxhimi i Kontratave Përmes E-Prokurimit", të organizuar nga "Prudencia Consulting", në Durrës – Shqipëri.
    - "Rregullat për Menaxhimin e Financave Publike, Regjistrat e Pasurive dhe Raportimi Vjetor nga Organizatat Buxhetore", të organizuar nga "Prudencia Consulting", në Durrës – Shqipëri.
    - Trajnim për mbrojtjen e të dhënave personale të organizuar nga Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ndryshimi Ligjit Për Prokurim Publik

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, është pjesë e grupit punues për ndryshime ligjore të cilët po planifikohen të bëhen në sferën e prokurimit publik të iniciuar në janar të vitit 2019 nga Ministria e Financave. Grupi Punues i themeluar nga të gjitha institucionet gjegjëse prej 23 anëtarësh, janë duke punuar në Draft Ligjin e Ri për Prokurim Publik.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka anëtarin e saj pjesë të grupit përmes të cilit po punon në pjesën për OSHP-në, gjithmonë duke pasur parasysh rëndësinë që ka OSHP-ja, për forcimin e tërësishëm të sistemit te prokurimit publik të Kosovës, si dhe trajtimin ligjor të ankesave në mënyrë profesionale dhe në baza ligjore.

6. AKTIVITETI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Puna gjatë vitit 2021

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2021 ka pranuar **881** ankesa gjithsej. Paneli shqyrtues ka marr vendime vetëm për 255 ankesa, ku ka aprovuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese, si të bazuara në **79** raste, duke konstatuar se pretendimet e palëve ankimore nuk kanë qenë të mbështetura në argumente ligjore që të aprovohen ankesat e tyre; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave në **110** raste, duke konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar i ofertave nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkeljet e caktuara të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ri-tenderim) në **5** raste, nisur nga shkeljet e konstatuara të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit, vlerësim jo të drejtë të ofertave apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit; **52** ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos-kompletimit të tyre brenda afatit ligjor në pajtim me nenet 111.4 dhe 118.1 të LPP-së; Para se të merren në shqyrtim nga Paneli Shqyrtues, **2** ankesa të dorëzuara, janë tërhequr nga operatorët ekonomik ankues; Paneli shqyrtues gjatë vitit 2021, ka lëshuar gjithsejtë **2** urdhëresa, Obligim i Autoritetit Kontraktues për sqarime shtesë **2** raste dhe Ndryshim në dosje të tenderit **3** raste si dhe,

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se në mungesë të bordit janë gjithsejtë **626** raste / ankesa pa vendime të panelit shqyrtues.

- Në formë grafike janë të paraqitura numri dhe përqindja e ankesave të pranuara dhe të shqyrtuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2021.



- Operatorët Ekonomik me rastin e paraqitjeve të ankesave konform nenit 118 të LPP-së, dhe Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave konform nenit 14 kanë qenë të obliguar të deponojnë sigurimin e ankesave një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

TABELA E ANKESAVE TE SHQYRTUARA

Autoriteti Kontraktues	Totali I ankesave	Aprovim I vendimit te AK-se	Rivleresim	Ritenderim	Flakje e ankeses	Terheqje e ankeses	Obligim I AK per sqarime	Urdherese	Ndryshim ne dosje te tenderit
Agjencia e Veterines dhe Ushqimit	6	1	3		2				
AKP	2	2							
AKSP	2		2						
AMKMK	1	1							
AQP	3		1		1				
ASK	3	1			2				
Dogana e Kosoves	6	3	1		2				
Gjykata Kushtetuese	1		1						
Iber Lepenci sha	3		3						
IKSHPK	2	2							
KEK	13	4	6		2	1			
KGJK	1		1						
KK Dragash	1		1						
KK Drenas	3	1	1		1				
KK Ferizaj	6	2	3						1
KK Fushe Kosove	4		4						
KK Gjakove	14	2	8		2		2		
KK Gjilan	2		1		1				
KK Graçanice	1				1				
KK istog	1	1							
KK Kaçanik	1				1				
KK Kline	2		2						
KK Lipjan	5	3	1		1				
KK Malisheve	1				1				
KK Mitrovice	3	1	2						
KK Obiliq	3	2	1						
KK Peje	7	5	2						
KK Prishtine	14	4	4	1	5				
KK Prizren	17	6	7		3			1	
KK Rahovec	1				1				
KK Suhareke	8	2	2	2	2				
KK Viti	3	1	1		1				
KK Vushtrri	4		4						
KMDK	1		1						
KOSST	3	2			1				
KPK	1		1						
KRM Pastrimi	1		1						

Autoriteti Kontraktues	Totali I ankesave	Aprovim I vendimit te AK-se	Rivleresim	Ritenderim	Flakje e ankeses	Terheqje e ankeses	Obligim I AK per sqarime	Urdherese	Ndryshim ne dosje te tenderit
KRU Hidromorava	1		1						
KRU Prishtina	4		1		3				
Kuvendi I Kosoves	1				1				
Ministria e Arsimit	7	2	2	1	1			1	
Ministria e Mbrojtjes	2		2						
Ministria e Shendetesise	11	2	3		4				2
MKK	2	2							
MKRS	7	1	5			1			
MMPH dhe I	4		2		2				
MPB	7	3	2	1	1				
MPJ dhe D	1				1				
MTI	3	2	1						
Ngrohtorja Gjakova	1		1						
Pallati I Rinise sha	1		1						
Policia e Kosoves	3	2	1						
QKTGJ	1	1							
QKUK	10	2	4		4				
SHKK	1				1				
SHSKUK	19	9	9		1				
Spitali I Prizrenit	1				1				
Termokos sh a	7	1	6						
Trepça sha	1				1				
Universiteti I Gjakoves	1		1						
Universiteti I Mitrovices	1	1							
Universiteti I Prishtines	7	4	2		1				
Zyra e Kryeministrit	1		1						
Gjithsejtë	255	79	110	5	52	2	2	2	3

Ndërsa nga numri total i ankesave të pranuara, kanë mbetur pa u shqyrtuar edhe 626 ankesa të vitit 2021 në mungesë të bordit.

GJOBAT DHE ANKESAT

- Ne vitin 2021 OSHP nuk ka inkasuar asnjë gjobë dhe nuk është gjobitur asnjë Autoritet Kontraktues , apo Operator Ekonomik.

Të hyrat të inkasuara nga gjobat e shqiptuara autoriteteve kontraktuese

Shuma e të arkëtueshmeve nga vitet paraprake është 296,000.00 Euro për Autoritete Kontraktuese.

Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik

- Gjatë vitit 2021, numri i ankesave sipas muajve kalendarik, ka pasuar ndryshime në disa muaj. Volumi më i madh i ankesave i përket muajve Janar, Shkurt, Mars dhe Prill. Në formë statistikore, në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i ankesave të pranuara sipas muajve gjatë vitit 2021



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Muajt	86	98	101	86	64	71	72	62	71	55	62	53
Gjithsejtë 881 ankesa												

Urdhëresat e Shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese

- Me LPP, përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pas shqyrtimit të ankesave, janë përfundimtare, mirëpo disa Autoritete Kontraktuese i kanë neglizhuar procedurat e prokurimit publik, duke mos i respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese për rivlerësimin e ofertave apo anulimin e aktiviteteve të prokurimit. Veprimet e këtilla të Autoriteteve Kontraktuese përbëjnë shkelje të LPP-së, e njëkohësisht kanë edhe efekt negativ në shfrytëzimin racional të fondeve publike.
- Për shkak të mos respektimit të vendimeve të mëparshme të Paneleve Shqyrtuese, OSHP-ja, ka shqiptuar gjithsej **2** urdhëresa ndaj Autoriteteve të ndryshme kontraktuese.

- Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat lidhur me shqiptimin e urdhëresave ndaj Autoriteteve Kontraktuese, për mosrespektim të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Urdhëresa te shqiptuara për mos respektim te vendimit te PSH-së
1	Ministria e Arsimit	1
2	KK Prizren	1
	Gjithsejtë	2

Diskualifikimi i Operatorëve Ekonomik

OSHP-ja është kompetente për diskualifikim të operatorëve ekonomik konformë nenit 99.2 të LPP-së. në vijim është tabela me të dhënat, kërkesat e autoriteteve kontraktuese dhe vendimet e OSHP-së në lidhje me këto kërkesa.

Gjatë vitit 2021 OSHP ka pranuar gjithsejtë 60 kërkesa për diskualifikim të operatorëve nga autoritete të ndryshme ku ndër këto kërkesa janë shqyrtuar 6 prej tyre ku në 3 raste

është refuzuar kërkesa e autoriteteve kontraktuese dhe në 3 raste është aprovuar kërkesa e autoritetit dhe janë diskualifikuar operatorët ekonomik, kurse në mungesë të bordit kanë mbetur pa shqyrtuar edhe 54 kërkesa te parashtruara nga Autoritetet kontraktuese /AK.

Tabela e kërkesave për diskualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe vendimet e OSHP

Nr	AK	OE	Aktiviteti	Data	Periudha e diskualifikimit	Statusi
1	KK Junik	As-Tech shpk	Furnizim me gjenerator per komunen e Junikut Ritender	15.02 deri 14.08.2021	6 muaj	Përfunduar
2	SHSKUK	Interlab shpk	Furnizim me material medicinal nga LE per nevojat e SHSKUK-se	01.02.2021 deri 31.01.2022	12 muaj	Përfunduar
3	UP	Yba shpk & Brothers Group & Basri Sopiani	Drenazhimi,kanalizimi, ujesjellesi ne Filologji FSHMN Filozofik L1,2	15.02 deri 15.08.2021	6 muaj	Përfunduar

Të Dhënat nga Gjykatat

- Gjatë vitit 2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte gjithsej tetëdhjetë e pesë (85) përfaqësime pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative dhe Departamentit për Çështje Ekonomike.

- Gjatë vitit 2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit është përgjigjur në padi, gjithsej, katër dhjetë e tetë (48) herë konform aktvendimeve për përgjigje në padi të dorëzuara nga gjykatat kompetente.

- Gjatë vitit 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar në pesëmbëdhjetë (15) raste kërkesëpaditë e paditëseve të parashtruara kundër vendimeve të

Organit Shqyrtues të Prokurimit, ndërkaq ka aprovuar paditë në gjashtë (6) raste, ka hedhur poshtë si të palejuar padinë në tri (3) raste, ndërkaq dy (2) paditës janë tërhequr nga paditë e parashtruara gjatë këtij viti.

- Paditësit/operatorët ekonomikë, kanë parashtruar shtatëmbëdhjetë (17) ankesa në Gjykatën e Apelit kundër vendimeve të Gjykatës Themelore, ndërsa OSHP ka parashtruar nëntë (9) ankesa në Gjykatë të Apelit.

- Në tetë (8) raste ankesat e paditësve/operatorëve ekonomikë janë refuzuar si të pabazuara nga Gjykata e Apelit. Në dy (2) raste, Gjykata e Apelit e ka aprovuar ankesën e paditësve/operatorëve ekonomikë si të bazuar, ndërsa në një (1) rast e ka hedhur poshtë ankesën si të palejueshme. Për më tepër, në dy (2) raste Gjykata e ka refuzuar ankesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit si të pabazuar.
- Lidhur me propozimet e paditësve/operatorëve ekonomikë për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, gjykatat në shtatë (7) raste kanë refuzuar propozimet e parashtruesve të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ,ndërsa në dy (2) raste e kanë aprovuar propozimin.

TË GJETURAT E ZYRËS SË PËRGJITHSHME TË AUDITORIT

- Të gjitha rekomandimet e bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për të gjeturat për vitin 2020, janë përmbushur nga OSHP, ndërsa për vitin 2021, Auditorit të Përgjithshëm ende nuk ka dal me Raport zyrtar për ndonjë të gjetur për OSHP-në.

Prishtinë, 28.02.2022

Ardian BEHRA

Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së